



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Lindi Markings Sh.P.K. & Beni Com Sh.P.K." të datës 12.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Llot IV" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 66 22 170 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Lindi Markings Sh.P.K. & Beni Com Sh.P.K." e datës 12.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Llot IV" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 66 22 170 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Lindi Markings Sh.P.K. & Beni Com Sh.P.K." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Lindi Markings Sh.P.K. & Beni Com Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 12.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Llot IV" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 66 22 170 211. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 7

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): "Konstatimi i komisionit vlersus se Juve ju mungon • Gjate vizitës ne vend punishte ne teren ju ka munguar Batipali per vendosjen e pahive elastike, Kamion per larje te rrugëve dhe makinë special për fshirjen e rrugëve - e pabazuar. Pergjat periudhes kohore te vlerësimit te ofertave komisioni i vleresimt, nuk ka realizuar vizite ne teren tek antari i Koncersjunit, rrjedhimisht grupi yne i OE-ve, ka plotesuar cdo kerkese te kualifikimit duke prezantuar deshmi konkrete edhe per paisjet tekenike, kjo konstatohet nga vet komisioni i vleresimit te ofertave. Abuzimi me etiken profesionale shperfaqet ne momentin kur ne leter standarde pershkruhet kerkesa e dosjes se tenderit dhe jo kerkesa e cila eshte ndryshuar dhe modifikuar, sipas njoftimit mbi korrigjim dhe permiresim te gabimit".

Pretendimi i dytë (II): "Pretendimi ankimore 2. I pa respektuar - Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores për Prokurimin Publik Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Pretendimi i tretë (III): "Pretendimi ankimore 3. I pa respektuar -Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Pretendimi i katërt (IV): "Pretendimi ankimore 4. I pa respektuar Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik".

Pretendimi i pestë (V): "Pretendimi ankimore 5. I pa respektuar Neni 11 - i rregullores 001/2022 Funkcionet e Departamentit /NjësiProkurimit 11.1 Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësitë në vijim: a. Në konsultim me të gjitha departamentet përgatitë një plan vjetor të prokurimit. b. Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive".

Pretendimi i gjashtë (VI): "Pretendimi ankimore 6. I pa respektuar Neni 59 Egzaminimi, Vlersimi dhe egzaminimi i tenderve 1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për egzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin dytësor lidhur me këtë çështje. 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet egzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues".

Pretendimi i shtatë (VII): "Pretendimi ankimore 7. I pa respektuar -Neni 60 Kriteret për Dhënie e Kontratës 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji".

Pretendimi i tetë (VIII): "Pretendimi ankimore 7. I pa respektuar Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale. 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen".

Pretendimi i nëntë (IX): "Pretendimi ankimore 8. 1. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim me nenin 414, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës; 2. Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik në kundërshtim me nenin 415, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës; Veprimet dhe konstatimet e komisionit ri vlerësues të ofertave, përveç që nuk janë të bazuara në dispozita ligjore, të njejtat veprime konsumojnë elementet bazike të verës penale të sanksionuar me ligj, Zyra e Prokurimit Prishtinë dhe komisioni vlersues në vendimin e datës 07.06.2023 rekomandojnë për kontratë Grupin e Operatorve Ekonomik TRAFFIKS VA SH.P.K&VIA SH.P.K&EUROKOS HOLLDING SH.P.K të cilet kanë oferten me çmim 86.20 euro për të gjitha njesit në DT, duke e krahasuar me oferten tonë e cila është për të gjitha njesit prej 51.50 euro edhe pse demtojnë buxhetin e Grupit të Operatorve komisioni vlersues i rekomandojnë për kontratë. Zyra e Prokurimit Prishtinë dhe komisioni vlersues shpërblen me kontratë grupin e operatorve ekonomik me ofertë financiare prej 34.70 ma e nëntë se oferta jon".

Pretendimi i dhjetë (X): "Pretendimi ankimore 9 I pa respektuar nga AK Shkeljet e rënda Neni 97 rregullorja 001/2022 d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kriterëve apo dëshmitëve jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njesisë së kërkesës. o. Nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik apo ndaj cilit do person gjatë ushtrimit të procedurës së prokurimit".

Pretendimi i njëmbëdhjetë (XI): *“Pretendimi ankimore 10 Prandaj, bazuar ne faktet, provat dhe bazën ligjore te prezantuar si me larte,nese ky AP nuk kthehet ne rivlersim dhe lenda shikon ne OSHP jemi te detyruar te kerkojm qe OSHP te zbatoj Nenin 25 pika 8 8. Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga IKAP mund të anulohet nga OSHP nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP duhet t'i dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe nenin 11 dhe 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 19.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I): fillimisht duhet theksuar që me datë 10.03.2023 komisioni vlerësues ka dërguar te parashtruesi një njoftim përmes adresës elektronike. Me këtë rast komisioni vlerësues ka njoftuar parashtruesin se me datë 13.03.2023 ndërmjet orës 10:00 deri në ora 15:00 do të dal në terren me qëllim që të verifikohet nëse parashtruesi i posedon të gjitha makineritë sipas aneksit 7 të DT. Në këtë njoftim specifikisht është cekur se *“Njëherit ju njoftojmë se të gjitha makineritë përfshirë edhe ato makineri qe I keni me kontrata qiradhënje te gjenden ne vendpunishtet e juaja”*. Ndaj këtij njoftimi parashtruesi asnjëherë nuk është përgjigjur për të treguar se jo të gjitha makineritë në fjalë ndodhen në vendpunishten e vet (siç pretendon parashtruesi), pavarësisht faktit që ka qenë i njoftuar me kohë për vizitën e komisionit vlerësues. Me fjalë të tjera parashtruesi nuk e konteston fare faktin që komisioni vlerësues përmes njoftimit me shkrim e ka njoftuar me kohë për vizitën në vendpunishten e tij. Njëkohësisht parashtruesi nuk e konteston as faktin që asnjëherë nuk ka reaguar ndaj këtij njoftimi paralajmëruar të komisionit vlerësues. Pra nuk është fare kontestuese që parashtruesi ka qenë i paralajmëruar se komisioni vlerësues me datë 13.03.2023 do të vizitoj vendpunishten e tij dhe aty do të kërkoj që të verifikoj posedimin e të gjitha makinerive sipas aneksit 7 të DT. Në anën tjetër duhet theksuar që parashtruesi (“Lindi Markings” në këtë tender ka ofertuar si konsorcium me OE “Beni Com”. Mirëpo lider i grupit ka qenë “Lindi Markings” prandaj komisioni ka zhvilluar vizitën në terren vetëm te lideri i grupit. Me rëndësi në këtë rast është që “Lindi Markings” si lider i grupit ka qenë i njoftuar paraprakisht me kohë përmes njoftimit me shkrim për kohën kur do të zhvillohet vizita e komisionit. Njëkohësisht është paralajmëruar se të gjitha makineritë përkatëse duhet të jenë prezente fizikisht në vendpunishte. Prandaj pretendimi i

parashtruesit se pajisja që i ka munguar atij në vendpunishte është ndodhur dikun tjetër, më tepër flet për neglizhencën e parashtruesit dhe mungesën e përkushtimit sesa për shkeljet ligjore që i pretendon parashtruesi. Përderisa parashtruesi ka qenë i paralajmëruar me kohë, i njëjti ka pasur mundësi që të kërkoj afat shtesë nga komisioni apo thjeshtë të kërkoj që komisioni të vizitoj edhe një lokacion tjetër. Mirëpo parashtruesi e ka injoruar në tërësi njoftimin paralajmërues të komisionit dhe nuk ka shfrytëzuar asnjë nga këto mundësi. Në këtë mënyrë komisioni vlerësues me rastin e daljes në vendpunishten e parashtruesit ka gjetur se të njëjtit i *"ka munguar Batipali per vendosjen e pahive elastike, Kamion per larje te rrugëve dhe makinë special për fshirjen e rrugëve"*. Përndryshe fakti që kjo makineri ka munguar në vendpunishten e parashtruesit nuk kontestohet as nga vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim. Në këtë mënyrë është gjetur që ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimet II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe X: duhet theksuar faktin që parashtruesi në fakt nuk ka arritur fare që të formuloj pretendime ankimore konkrete. Në vend të kësaj parashtruesi në emër të "pretendimeve" vetëm ka cituar dispozita të LPP apo të RRPP. Si shembull, ajo që parashtruesi e prezanton si pretendim të dytë (II) në fakt është neni 1 i LPP të cilit i shtohet vetëm parashtesa *"I pa respektuar"*! Parashtruesi nuk jep asnjë argument, dëshmi apo provë pse nuk qenka respektuar kjo dispozitë e LPP por thjesht thotë që nuk është respektuar dhe e citon dispozitën si të tillë. Ngjashëm vepron edhe me pretendimin e tretë (III) ku e citon nenin 6 të LPP, pastaj me pretendimin e katërt (IV) ku e citon nenin 7 të LPP, pastaj me pretendimin e pestë (V) ku e citon nenin 11 të RRPP, pastaj me pretendimin e gjashtë (VI) ku e citon nenin 59 të LPP, pastaj me pretendimin e shtatë (VII) ku e citon nenin 60 të LPP, pastaj me pretendimin e tetë (VIII) ku e citon nenin 69 si dhe me pretendimin e dhjetë (X) ku e citon nenin 97 të RRPP. Pra të gjitha këto pretendime të parashtruesit në fakt nuk janë fare pretendime por vetëm citime (copy-paste) të dispozitave përkatëse ligjore. Kuptohet se një pretendim ankimor (prej vet fjalës pretendim) duhet të formulohet në atë mënyrë që parashtruesi duhet të argumentoj pse një veprim apo mosveprim i caktuar i autoritetit kontraktues është në kundërshtim me një dispozitë të caktuar ligjore në fuqi. Kuptohet që autoriteti kontraktues e njeh ligjin (*jura novit cura*) prandaj nuk ka nevojë të përshkruhen dispozitat në kërkesën për rishqyrtim. Sidoqoftë në rastin konkret parashtruesi përmes këtyre pretendimeve e ka bërë pikërisht përshkrimin e disa dispozitave ligjore dhe pikërisht këto i ka emërtuar si pretendime mirëpo në fakt i njëjti nuk ka arritur fare që të formuloj pretendime konkrete ankimore ose të paktën të tentoj që të argumentoj nëse ka pasur shkelje të dispozitave ligjore që parashtruesi i ka përshkruar (cituat). Për këto arsye, ato që parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim i evidenton si pretendimi II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe VIII, janë tërësisht të pabazuara dhe në fakt nuk janë fare pretendime por vetëm përshkrime/citime të dispozitave ligjore përkatëse të LPP dhe RRPP.

Lidhur me pretendimin e nëntë (IX): parashtruesi aludon se komisioni vlerësues ka kryer një vepër penale duke ju referuar nenit 414 të KPRK. Megjithatë zyrtari përgjegjës i prokurimit në rastin konkret nuk është organ kompetent për të hetuar apo për të gjykuar dyshimet e parashtruesit për vepra penale. Për shqyrtimin e këtyre pretendimeve

respektivisht dyshimeve të parashtruesit, ekzistojnë organe tjera kompetente sipas ligjit në fuqi dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera këtë pretendim/dyshim parashtruesi e ka adresuar te autoriteti jokompetent. Rrjedhimisht për autoritetin kontraktues ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar në tërësi. Megjithatë duhet shtuar se fakti që parashtruesi nuk ka arritur që të rekomandohet si tenderues i suksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit, nuk do të duhej të përbente dyshim për vepër penale. Kjo do të nënkuptonte që sa herë që parashtruesi të dorëzojë një ofertë për një aktivitet të prokurimit, ose duhet ai të shpallet fitues patjetër dhe me çdo kusht ose autoritetit kontraktues do të hetohet për vepër penale. Për këtë arsye autoriteti kontraktues si gjithmonë është i kujdesshëm që me rastin e zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit, në çdo fazë të respektohen në tërësi dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe si tenderues i suksesshëm të shpallet ai OE që plotëson kriteret e DT dhe të LPP në mënyrën më të mirë të mundshme. Pikërisht në këtë mënyrë është vepruar edhe në rastin konkret (pra sipas LPP dhe RRPP). Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument të vetëm, dëshmi apo provë për të vërtetuar të kundërtën dhe për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj edhe ky "pretendim" është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e njëmbëdhjetë (XI): duhet cekur se parashtruesi edhe këtë pretendim (ngjashëm si pretendimin e nëntë) e ka formuluar duke përdorur një gjuhë mjaft kërcënuese në raport me autoritetin kontraktues. Kjo për arsye se parashtruesi kushtëzon autoritetin kontraktues ose për të miratuar kërkesën e tij për rishqyrtim ose në të kundërtën "*lenda shkon ne OSHP jemi te detyruar te kerkojm qe OSHP te zbatoj Nenin 25 pika 8*" (që ka të bëjë me revokimin e licensës së prokurimit). Në këtë formë ky formulim i parashtruesit në fakt nuk është fare pretendim ankimor por vetëm një paralajmërim kërcënues. Lidhur me këtë duhet theksuar sërish që autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në përputhje të plotë me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të LPP dhe të RRPP. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument të vetëm, dëshmi apo provë për të vërtetuar të kundërtën dhe për të mbështetur pretendimin e tij. Në këtë kontekst parashtruesi është i lirë që të shfrytëzojë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për të mbrojtur të drejtat që ai pretendon se i takojnë. Megjithatë parashtruesi në asnjë rast nuk e gëzon të drejtën që duke u fshehur pas këtyre mjeteve ligjore të përdor gjuhë kërcënuese ndaj autoritetit kontraktues. Kjo për arsye se autoriteti kontraktues të veprim të vet e mbështet vetëm në argumente ligjore dhe në ligjet në fuqi por jo edhe në gjuhën kërcënuese apo shatanzhuese që mund të përdoret nga parashtruesit përmes kërkesave të tyre për rishqyrtim. Sidoqoftë, për këto arsye edhe ky "pretendim" i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Duhet pasur parasysh që parashtruesi në këtë aktivitet të prokurimit është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Prandaj në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP, nuk është fare palë e interesuar sa i përket pretendimeve të tij lidhur me tenderuesin e suksesshëm sipas rekomandimeve të komisionit vlerësues dhe njoftimit mbi vendimin të autoritetit kontraktues.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.06.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.